

ARTIZANËT PËR TRASHËGIMINË KULTURORE - ARTCULT

Konteksti

Për të adresuar nevojat e Bashkisë së Kavajës dhe të Rogozhinës, projekti do të kontribuojë në rritjen e mundësitë e tyre të zhvillimit social-ekonomik, nëpërmjet vlerësimit të trashëgimisë kulturore, integritit të grupeve vulnerabël në sektorin e punimeve artizanale tradicionale dhe ngritjes së kapaciteteve të artizanëve individualë dhe NVM-të artizanale. Kur të dyja zonat të marrin promovimin e duhur, numri i vizitorëve në zonë dhe të ardhurat financiare të krijuara nga atraksionet turistike do të rriten. Kjo nxitje e turizmit dhe zhvillimit ekonomik do të mbështesë krijimin e vendeve të punës në këto zona. Projekti gjithashtu do të rrisë ndërgjegjësimin publik dhe institucional mbi rolin e rëndësishëm që luan trashëgimia jonë kulturore e përbashkët në stimulimin e avancimit ekonomik të vendit tonë.

Objektivat e Projektit

Objektivat specifike të këtij projekti janë:

- Identifikimi i mundësive të zhvillimit socio-ekonomik vendor të trashëgimisë kulturore të Kavajës dhe Rogozhinës;
- Rritja e ndërgjegjësimin për rolin e trashëgimisë kulturore si nxitës i zhvillimit vendor;
- Zhvillimi i kapaciteteve të zejtarëve tradicionalë, me theks të veçantë tek gratë dhe grupet vulnerabël.

Produktet

- Hartëzimi i artizanëve të punimeve artizanale tradicionale;
- Rekomandime mbi mundësitë për rjetësimin e trashëgimisë kulturore të Kavajës dhe Rogozhinës;
- Identiteti vizual i tre NVM-ve artizanësh;
- Guidë turistike që promovon pikat e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Kavajës dhe Rogozhinës;
- Pjesëmarrja në një panair vendas të trashëgimisë kulturore, për të promovuar punën e artizanëve;
- Tre video promovuese të artizanëve në punë në atelietë e tyre;
- Trajnimi i trajnerëve për artizanët nga Kavaja dhe Rogozhina;
- Kurs 8-javor mbi aftësitë artizanale tradicionale për artizanët e rinj;
- Trajnime dhe seminare mbi tregun online, marketingun në media sociale dhe foto dhe videografi;
- Vizitë studimore në një biznes artizanal në Shqipëri;
- Asistencë për shkrimin e projekteve për artizanët.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

DONATORI:

Komisioni Evropian

PARTNER:

- Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU)
- Kube Studios

KOHËZGJATJA:

01/10/2022 - 01/10/2023

KONTAKT:

Zana Vokopola

Drejtor Ekzekutiv

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd. 14 Hyrja 11,

Ap. 56 Tiranë, Shqipëri

M: +355694333808

E : zvokopola@uri.org.al

Breth IKU

Që nga viti 1999, Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë fokusohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë në qeveri, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim qasjen e publikut në informacion dhe lidhim partnerët e zhvillimit. URI ka punuar me donatorë si USAID, Swiss Cooperation, Ambasada Hollandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Fondacioni Shoqëria e Hapur, etj.



Funded by the
European Union